mund të punësojnë për shkak të profilit të punës. Pikërisht momenti i derdhjes së kontributeve nga kompanitë që nuk kanë mundësi punësimi, ka marrë vëmendjen e anëtarëve të Dhomës Amerikane, të cilët kanë dashur më shumë informacion mbi tekniciliatetin e kësaj pagese. Mënyra se si do paguhen dhe koha kur hyn në fuqi dhe e bën të detyrueshme pagesën, kanë qenë pyetjet e ngritura nga anëtarët. Znj. Sorensen duke folur për zbatueshmërinë e ligjit ka sqaruar bizneset në takim se ligji do të hyjë në fuqi në prill të 2020-ës, dhe ndërkohë po punohet për të nxjerrë edhe aktet udhëzuese që do ta udhëzojnë qartë këtë procedurë.

Anëtarët e Dhomës Amerikane kanë diskutuar mbi mundësinë e ngritjes së një grupi pune me përfaqësi edhe nga biznesi, për të mundësuar hartimin e akteve udhëzuese që jo vetëm facilitojnë zbatimin, por edhe marrin në konsideratë çështjet që biznesi kalon gjatë zbatimit të një ligji.

Ndërsa Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit, ligjit dhe programeve për zhvillimin e punësimit, Inspektoriati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e tij. Duke folur për këtë aspekt të monitorimit të ligjit, kryeinspektori Arben Seferaj ka shpjeguar për të gjithë anëtarët se portali i Inspektoriatit ka të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi inspektimin, dispozitat ligjore dhe rregullat mbi të cilat organizohet një inspektim.

## SI KRYHET NJË INSPEKTIM

Platforma e re tenton të bëjë transparente çdo pjesë të inspektimit dhe udhëzon bizneset mbi gjithçka që duhet të kenë në konsideratë gjatë një kontrolli. Ekspertët e Inspektoriatit kanë sqaruar se forma më e shprehur e një inspektimi është përmes informacionit paraprak që i lë kohën e nevojshme biznesit të përgatitet dhe të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm. Por kjo nuk i heq të drejtën një inspektori, i cili mbështetur në analizat e tij të riskut të bëjë një kontroll të befasishëm në ambjentet e biznesit. "Këtë të drejtë, Inspektorit ia jep Ligji dhe ky nuk mund të jetë një argument i kundërshtimit nga ana e bizneseve" – u shprehen ekspertët e Inspektoriatit të Punës. Lidhur me legjitimitetin e kontrollit dhe rritjen e transparencës së tij, kryeinspektori Seferaj u shpreh se qëllimi është të sigurohet zbatimi i ligjit dhe jo penalizimi i bizneseve. "Nuk ka penalizim në kontrollin e parë, pavarësisht mangësive që mund të gjejmë. Kontrolli nuk është një shkop që e kemi kthyer kundër bizneseit, përkundrazi, e kemi kthyer nga inspektorët për të minimizuar çdo rast të abuzimit dhe korrupsionit" – u shpreh z. Seferaj.

## INSPEKTIME NË DEGËT E KOMPANIVE NË RRETHE

Anëtarët e Dhomës Amerikane janë shprehur gjatë takimit se duhet patur në konsideratë që inspektimet të kryehen jo në degët e kompanisë, por në zyrat qendrore, pasi një pjesë e mirë e dokumentacioneve që kontrollohen, në fakt janë dosje që qëndrojnë në qendër. Znj. Blerina Krantja, nga kompania NOA ka sjellë shembuj të inspektimeve që kryhen në degët e tyre në rrethe, ndërkohë që qendra nuk ka asnjë informacion për këto inspektime, dhe për me tepër, nuk ka kohë në dispozion për të mundësuar dorëzimin e gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Por ekspertët e Ministrisë kanë sqaruar se ligji e lejon një inspektor të bëjë kontroll edhe në degët e një kompanie në rrethe, pasi tre nga dokumentat që kontrollohen janë detyrim ligjor që t'i ketë çdo degë.

"Ne kemi të drejtë t'i kërkojmë çdo degë kudo që ndodhet të ketë dokumentin e vlerësimit të riskut, deklaratën për aksidentet si dhe listën e lëndeve rrezatuese" – u shpreh eksperrtja e këtij Inspektoriati.

## LEJET VJETORE, SI DUHET TË TRAJTOHET LIGJI

Takimi me Kryeinspektorin ka patur dhe një diskutim mbi ditët e lejes vjetore që marrin punonjësit. Një pjesë e konsiderueshme e anëtarëve prezentë në takim, e kanë patur këtë shqetësim pasi ligji specifikon që punëdhënësi duhet t'i japë minimalisht 7 ditë pune nga pushimet vjetore punonjësit. Por nga ana tjetër, punëmarrësi nuk e ka këtë detyrim në ligj dhe për nevojat e veta mund të kërkojë dy apo tre ditë pushim nga ditët e lejes.

Kjo konsiderohet gabim nga kontrollet e Inspektoriatit të Punës dhe biznesi kërkon të merret në konsideratë dhe akordimi dy ditor i lejes. Ekspertët e Inspektoriatit të Punës kanë sqaruar se çështja në fjalë është ngritur vazhdimisht nga bizneset dhe ata kanë kërkuar një opinon nga juristët që kanë hartuar Kodin e Punës dhe iu është kërkuar ta zbatojnë ligjin siç është i shprehur me afatin kohor 7 ditor.

Kanë qenë të shumta pyetjet dhe diskutimet e punonjësve të HR-it, por edhe të juristëve të kompanive anëtare të AmCham mbi këtë çështje. Këmbëngulja e tyre motivohej nga fakti se Kodi i Punës specifikon se është punëdhënësi ai që e ka detyrimin e akordimit të një lejeje 7 ditore, ndërkohë që punëmarrësi nuk është i specifikuar në ligj. Kjo do të thotë që ai e ka të drejtën të bëjë kërkesë për dy apo tre ditë pushim. Kjo çështje e shumë diskutuar, mbetet një nga temat për të cilat Komiteti i Punës dhe i Etikës në Dhomën Amerikane do të punojë ngushtë me institucionet ligjhartuese dhe ligjzbatuese.

# AmCham addresses informality and VAT reimbursement issues at meeting with tax director

The American Chamber of Commerce in Albania has given new impetus to its working relationships with the tax and customs administrations -- two entities that have a major impact on business activity.



To create a win-win partnership, an AmCham working group led by President Enio Jaco recently met with new General Director of Taxes Ms.Delina Ibrahimaj. The meeting served to acquaint Ms. Ibrahimaj with AmCham leadership as well as to talk about issues affecting businesses and how to best address them.

Mr. Jaco introduced the tax director to AmCham's training and development work for members as well as the chamber's lobbying efforts and the goal of improving Albania's business climate. AmCham has had a good cooperation with the General Directorate of Taxes over the years and wishes to continue the same trend in the future. The heads of AmCham's Legal and Regulatory Committee as well as Taxes and Customs Committee -- Kledi Kodra and Alketa Uruci -- also attended the meeting, which also included Executive Director Mr. Ilir Trimi and Secretary of the Board Mr.Reshard Kellici. AmCham representatives spoke about the chamber's recent work on the fiscalization draft law and on the needed cooperation to create a positive impact through the new law.

Director Ibrahimaj briefed AmCham representatives on her administration's work in preparation for the soon-to-be-implemented tax law, the risk analysis on tax inspections, the fight against informality and increasing revenue for the state budget.

As part of the cooperation between the two institutions, participants also discussed the possibility of exchanging experiences and providing training sessions by AmCham experts for tax administration officials.

Reflecting on the issues that AmCham's business community faces in its day-to-day business, Ms. Uruci cited informality and VAT reimbursement as two major problems affecting businesses that follow the rules, threatening their market space and causing problems with liquidity.

Ms. Ibrahimaj said the fiscalization draft law would give a definitive solution to the question of informality, a very positive move. She added that a group of experts was working to decide on the timing and manner of VAT refunds.

> AmCham representatives spoke about the chamber's recent work on the **fiscalization draft law and on the needed cooperation to create a positive impact through the new law**






# Dhoma Amerikane flet me Drejtoren e Tatimeve për çështjet e informalitetit dhe rimbursimit të TVSH-së

Dhoma Amerikane ka stimuluar raportet e punës me institucionet e tatimeve dhe doganave si dy administrata që kanë një ndikim të madh në aktivitetin e biznesit.

Për të formatuar një bashkëpunim që i shërben ndihmës së ndërsjelltë, një grup pune i Dhomës Amerikane të Tregtisë i kryesuar nga Presidenti i Dhomës z. Enio Jaço, është takuar me Drejtoren e re të Tatimeve, znj. Delina Ibrahimaj.

Takimi ka shërbyer jo vetëm për ta njohur z. Ibrahimaj me autoritetet që punojnë dhe drejtojnë strukturat kryesore në AmCham, por dhe për të folur mbi çështje të aktivitetit të përditshëm të biznesit dhe mënyrës më të mirë për t'i adresuar ato.

Z. Jaço e ka njohur Drejtoren e Tatimeve me punën që bën Dhoma Amerikane për të trajnuar e zhvilluar anëtarët e saj, si dhe për proceset lobuese ku përfshihet me qëllimin që të përmirësojë klimën e biznesit. Dhoma ka patur një bashkëpunim të mirë në vite me Drejtorinë e Tatimeve dhe dëshiron të vazhdojë të njëjtin trend edhe në vijim. Në takim kanë qenë prezentë edhe dy kryetarët e Komiteteve, Kryetari i Komitetit të Çështjeve Rregullatore, Ligjeve dhe IPR-it, z. Kledi Kodra, dhe Kryetarja e Komitetit te Taksave dhe Doganave, znj. Alketa Uruçi. Gjithashtu, në takim morën pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv i AmCham, z. Ilir Trimi dhe Sekretari i Bordit, z. Reshard Këlliçi. Përfaqësuesit e Dhomës Amerikane kanë folur mbi punën që po bën Dhoma se fundmi me projektligjin e fiskalizimit dhe mënyrën se si duhet bashkëpunuar për të sjellë ndikimin më të mirë nga ky projektligj. Drejtoresha e Tatimeve i ka njohur përfaqësuesit e Dhomës Amerikane mbi punën që po bën administrata e saj për t'u përshtatur me ligjin e fiskalizimit që do të fillojë zbatimin së shpejti, analizat e riskut mbi inspektimet tatimore, luftën kundër informalitetit dhe rritjen e të ardhurave buxhetore.

Në kuadër të bashkëpunimit mes dy institucioneve është diskutuar dhe mundësia e shkëmbimit të eksperiencave dhe ofrimit të trajnimeve dhe seminareve për administratën e tatimeve nga ana e ekspertëve të Dhomës Amerikane. Duke folur për problematikat që komuniteti i biznesit të Dhomës përballet në aktivitetin e përditshëm, znj. Uruçi ka përmendur informalitetin dhe rimbursimin e TVSH-së, si dy problematika madhore të cilat afektojnë bizneset formale, duke kërcënuar hapësirën e tyre në treg, por dhe duke i shkaktuar problematika me likuiditetet. Znj. Ibrahimaj u shpreh entuziaste se projektligji për fiskalizimin do t'i jepte një zgjidhje definitive çështjes së informalitetit, ndërkohë që po punohej me një grup ekspertësh për të vendosur në kontroll afatet dhe mënyrën e rimbursimit të TVSH-së.

> Përfaqësuesit e Dhomës Amerikane kanë folur mbi punën që po bën Dhoma se fundmi me projektligjin e fiskalizimit dhe **mënyrën se si duhet bashkëpunuar për të sjellë ndikimin më të mirë nga ky projektligj.**




PËRPARI TUSHAJ





KLODIAN CICI

## THE NEW HEALTH LAW

# *On the ground inspections create challanges for the tabacco industry*

The American Chamber of Commerce in Albania met with experts from the Ministry of Health and the Health Inspectorate to discuss how to best perform inspections on the ground related to tobacco product sales, as the new Law on Health and Tobacco Products is implemented.

AmCham has been very active in the discussion and approval of the draft law on health and tobacco, which aims to better regulate the tobacco industry based on best European practices that allow state budgets to draw more income from this market. Meanwhile, an inspection campaign organized by the National Health Inspectorate, pursuant to Law 9636 (Law on the Protection of Health from Tobacco Products), highlighted issues with the implementation of the law on which AmCham was invested in organizing a roundtable discussion.

Removing cigarette shelves and covering cigarettes so they are not visible in shops, banning the sale of packs with less than 20 cigarettes and getting the correct information on the changes applied to Article 13 of the tobacco law were issues discussed at a meeting with the Ministry of Health and the National Health Inspectorate.

AmCham played the role of mediator between the tobacco industry and the Ministry of Health to bring to the table a constructive spirit of discussion and to create an atmosphere where both sides can find a win-win solution. AmCham Executive Director Ilir Trimi praised the readiness of the Ministry of Health to create a working group and to speak specifically about the measures that need to be taken to have an effective control system on the tobacco market. The current cooperation of AmCham and the tobacco industry with the Ministry seen as productive, and dialogue and the concrete discussion of the problems and solutions offered are seen as key in that relationship.

Representatives of the tobacco industry, well-known brands in the international market, brought their experience to the Albanian market and the way they thought they could draft a document that clearly sets out the legal obligations of retailers based on changes to the new Health and Tobacco Law.

Talking about their role in the market, the industry representatives brought figures on the potential damage that could be caused should the informal tobacco industry start to withdraw from the Albanian market. Repressive forms of control discourage legal sellers from trading tobacco products, redirecting consumers to the informal trade, which, in Albania, is unfortunately one of the highest in the region and Europe, accounting for more than 30 percent of the total market. Translated into concrete figures, the impact is worth 50-100 million euros less to the state budget from the excise tax alone.

Parties at the meeting agreed that inspection groups should consider the concerns of the industry and should work closely with it to have an exchange of information between the two parties and to coordinate the activities of the tobacco industry in the market in accordance with the rules set in Albanian law.





## LIGJI I RI PËR SHËNDETIN

# *Inspektimet në terren krijojnë sfida për industrinë e duhanit*

Dhoma Amerikane, ka qenë mjaft aktive gjatë diskutimit dhe miratimit të projektligjit mbi Shëndetin, qëllimi i të cilit ishte të rregullonte veprimtarinë e kësaj industrie në treg mbështetur në eksperiencat më të mira Evropiane dhe t'i jepte mundësi buxhetit të shtetit të përfitonte nga kjo veprimtari.

Ndërkohë, fushata e inspektimit e organizuar nga Inspektoriati Kombëtar i Shëndetit, në zbatim të ligjit 9636, po shfaqte disa problematika të zbatimit rigoroz të këtij ligji, për të cilin Dhoma Amerikane u investua në organizimin e një tryeze të rrumbullakët diskutimi.

Heqja e rafteve dhe mbulimi i tyre ose heqja e paketave të cigareve nga vende të dukshme në Pikën e Shitjes, ndalimi i shitjes së paketave të cigareve me më pak se 20 cigare dhe informimi korrekt për ndryshimet që ndodhin në nenin 13 të Ligjit të Duhanit, kanë qenë çështjet e shtruara për diskutim në takimin me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Inspektoriatin Kombëtar të Shëndetit.

Dhoma Amerikane luajti rolin e një ndërmjetësi mes industrisë së duhanit dhe Ministrisë së Shëndetësisë për të sjellë në tavolinë një frymë konstruktive të diskutimit dhe për të krijuar një atmosferë ku të dyja palët gjejnë një zgjidhje që i bën fituese.

Drejtori Ekzekutiv i Dhomës Amerikane, z. Ilir Trimi, ka vlerësuar gatishmërinë e Ministrisë së Shëndetësisë për të krijuar një grup pune dhe për të folur konkretisht për masat që duhet të ndërmerren për të patur një sistem efikas kontrolli. Bashkëpunimi i deri tanishëm i Dhomës dhe industrisë së duhanit me këtë Ministri, konsiderohet si një nga më produktivet dhe çelësi ka qenë pikërisht tek dialogu dhe diskutimi konkret i problematikave dhe i zgjidhjeve që ofrohen.

Përfaqësuesit e industrisë së duhanit si emra të njohur në tregun ndërkombëtar, kanë sjellë eksperiencën e tyre në tregun shqiptar dhe mënyrën se si ata mendonin se mund të hartonin një dokument që përcakton qartë detyrimet ligjore të tregtarëve me pakicë mbështetur në ndryshimet që pësoi ligji “Për Shëndetin dhe Duhanin”.

Duke folur për rolin e tyre në treg, ata kanë sjellë shifra të dëmit që shkaktohet nëse industria e formalizuar e duhanit fillon të tërhiqet nga tregu. Format represive të kontrollit, dekurajojnë shitësit legalë që të mbajnë produkte duhani, duke i orientuar konsumatorët drejt tregtisë informale që fatkeqësisht është një nga më të lartat në rajon dhe Evropë, që zë mbi 30% të totalit. E përkthyer në shifra konkrete, ky impakt vlen 50 - 100 milion euro më pak çdo vit vetëm nga akciza e duhanit në buxhetin e shtetit.

Gjatë takimit, është rënë dakord që grupet e inspektimit do të kenë në konsideratë shqetësimet e kësaj industrie dhe do të punohet ngushtë për të patur një shkëmbim të informacionit mes dy palëve dhe për të koordinuar veprimtarinë e industrisë së duhanit në treg konform rregullave.








# THE DIGITAL BUSINESS COMMITTEE

## starts work on improving Albania's legislation landscape and guiding AmCham members create their digital agenda

AmCham's Digital Business Committee has set its first steps on the long path of educating and informing businesses on the importance of having a digital-ready economy and society. The committee started work by focusing the attention of its members on the fundamental issues that will affect its future operations. Welcoming all members to the new group, AmCham President Mr. Enio Jaco praised the great role digitalization plays in a competitive economy and the opportunities the committee provides to convey to business leaders ideas that drive innovation.

"As we speak of a digital future, the reality is that digitalization is already here," said President Jaco, encouraging the committee to prioritize dealing with topics that facilitate the digitalization process in the day-to-day operations of businesses. Committee Chairman Mr. Achileas Kanaris presented members with the issues seen as a priority in building a digital society and touched on the needed infrastructure to create a digital society, the legislation on which digital platforms will be built as well as the impact the committee should have on priority sectors such as digital and youth education, e-signatures, Smart Tirana and other tech innovations the capital needs.

AmCham Executive Director Mr. Ilir Trimi emphasized that it is important for the chamber to have a strategy and an activity plan that serve the three pillars on which AmCham's work is based -- advocacy, networking and professional development. During the discussion with group members, Mr. Jaco suggested that the committee's first meeting should focus on talking about drafting a strategy to set out its future work priorities, setting out a clear work plan for how it will operate to achieve its objectives.

Committee members introduced themselves to the group and put forward proposals and ideas on what they see as priority issues to be considered by the committee, keeping in mind the goal to bring an impact on digital developments and for AmCham members to serve as leaders in the new digital economy. Ms. Linda Shomo of Easy Pay, and committee deputy chairwoman, raised the issue of e-commerce and its increasing role in the country's economy. The impact of the cash economy is significant on the country's GDP, estimated at 2 percent. Seeking to have a committee that can serve all industries, members asked that it play a leading role in upcoming digital changes that will help create more value for businesses.

"The value of digital processes seems to be having a concrete opportunity to use them to save time and costs. Digitalization should begin with concrete steps in the way businesses operate, things like electronic signatures and payments, without the need to double up the work and using actual paper," said Mr. Gjergj Guri of Facilization.






# KOMITETI I BIZNESIT DIGJITAL

## fillon punën për të përmirësuar legjislacionin shqipëtar dhe t'i drejtojë anëtarët e AmCham në krijimin e axhendës së tyre digjitale

Komiteti i Biznesit Digjital fillon rrugën e gjatë të edukimit dhe informimit të bizneseve me proceset e digjitalizimit të ekonomisë dhe shoqërisë. Komiteti i Biznesit Digjital ka filluar punën duke fokusuar vëmendjen e anëtarëve të saj në çështjet themelore që do të prekin veprimtarinë e tij. Duke përshëndetur të gjithë anëtarët e këtij grupimi të ri që i bashkohet strukturave drejtuese në Dhomën Amerikane, Presidenti Enio Jaço ka vlerësuar rolin e madh të digjitalizimit në një ekonomi konkurruese dhe mundësitë që ky Komitet do të ofrojë për të zhvilluar inovacionin tek liderët në biznes.

"Ndërsa flasim për një të ardhme digjitale, digjitalizimi është tashmë prezent" - u shpreh Presidenti Jaço duke inkurajuar Komitetin të bëjë çështje prioritare pikërisht ato tema që i japin jetë procesit të digjitalizimit në veprimtarinë e përditshme të biznesit. Kryetari i këtij Komiteti, z. Achilleas Kanaris, ka orientuar anëtarët e Komitetit mbi çështjet e propozuara si prioritete në shoqërinë digjitale dhe që prekin infrastrukturën për të ndërtuar një shoqëri digjitale, legjislacionin mbi të cilin do të ngrihen platformat digjitale, ndikimin që duhet të ketë ky Komitet në sektorët prioritarë, si edukimi apo 'youth education', 'e-signature' e deri tek 'Smart Tirana' dhe novacionet 'tech' për të cilat kryeqyteti ka nevojë.

Drejtori Ekzekutiv, z. Iliri Trimi, vendosi theksin në faktin se është e rëndësishme për Dhomën Amerikane që strategjia mbi të cilën do të zhvillojë punën dhe draft-plani i aktiviteteve që do të dalë prej tij, t'i shërbejnë tre shtyllave themelore mbi të cilat mbështetet puna e Dhomës Amerikane, Avokim, Network dhe Zhvillim Profesional.

Gjatë diskutimit me anëtarët e këtij grupimi, z. Jaço ka sugjeruar që Komiteti në takimin e parë të tij të përqendrohet në diskutimin për hartimin e një draft strategjie, e cila do të ketë të përcaktuara prioritetet mbi të cilat do të punojë, dhe për rrjedhojë, të përcaktojë dhe një plan pune të qartë se si do të realizohen këto objektiva. Anëtarët e Komitetit pas prezantimit individual kanë dhënë propozime dhe ide se me çfarë duhet të merret si çështje prioritare ky Komitet, për të sjellë një ndikim në zhvillimet digjitale dhe të jetë orientues në një epokë të re digjitale për të gjithë anëtarët. Znj. Linda Shomo nga EasyPay, Nënkryetare e këtij Komiteti, ka ngritur çështjen e 'E-Commerce' dhe rolit që po merr gjithnjë e më shumë ky proces për ekonominë e vendit. Ndikimi i ekonomisë *cash* është i ndjeshëm në GDP-në e vendit dhe është llogaritur në masën 2 për qind. Duke dashur që ky Komitet t'i shërbejë të gjitha industrive, është kërkuar të luajë rolin orientues drejt ndryshimeve digjitale dhe vlerën që ato i japin biznesit.

"Vlera e proceseve digjitale duket kur ti ke mundësi konkrete t'i përdorësh ato, duke shkurtuar kohë dhe kosto. Digjitalizmi duhet të fillojë me hapa konkretë në mënyrën se si bizneset do të organizojnë proceset e punës me nënshkrimet dhe pagesat elektronike, pa qenë nevoja të bëjnë punë dyfishe dhe t'i kthehen edhe punës me letër" - ka thënë z. Gjergj Guri nga Facilization.



The meeting served as a good networking foundation to share information on AmCham's work to guide businesses in Albania toward digital development and to provide them with up-to-date information on changes to the law on personal data protection.

AMCHAM BOARD AND DIGITAL BUSINESS COMMITTEE HOLD WORKING **BREAKFAST WITH AMCHAM WASHINGTON REPRESENTATIVE**

# *Data protection and the digital economy were focus of discussion*

Mr. Evangelos Razis, Manager for International Policies in Digital Economics at the American Chamber of Commerce in Washington, visited Albania in the framework of an international conference on personal data protection, taking the opportunity to start his visit with a meeting with the AmCham Albania Board of Directors and members of the AmCham Digital Business Committee.

The meeting served as a good networking foundation to share information on AmCham's work to guide businesses in Albania toward digital development and to provide them with up-to-date information on changes to the law on personal data protection.

Mr. Razis presented the work of AmCham Washington and the department he leads and spoke about policy-making on digitalisation in the economy, developments in the private sector as well as standard rules and regulatory processes related to data collection and processing in a global economy. Increasingly, artificial intelligence is the innovation that serves as a focus of interest at AmCham Washington and digital policy departments. Mr. Razis said he believed that attending the data protection conference presented a good opportunity to interact with colleagues from other AmChams and talk about the work being done to establish legislation to regulate business and government activity when it comes to data collection and storage. AmCham Albania President Enio Jaço emphasized the fact that the Chamber has just created a Committee that directly responds to the needs of digital development, working together with the best experts in the field.

"This Committee will not only guide digital development education of the private sector, but will also have a leading role in the processes for drafting proper laws that will help to propel this process further," Mr. Jaco said. AmCham members had much to discuss with Mr. Razos on data protection legislation in the United States, how local and global trade agreements are honored, while respecting data protection as well as the role of government in these developments. Cyber security was another favorite subject, given the risks seen worldwide in today's electronic communications and e-commerce. The need for unification of laws and ratification of international agreements that could bring data protection practices under one umbrella was raised by AmCham Executive Director Mr. Ilir Trimi, who opened a discussion on the complexity of the online trading relationships. While Albania is small and doing its part to cope with the challenges of our time, relations regulated on the basis of the EU General Data Protection Regulation (GDPR) have become strong and complicated. This can be seen in relationships that emerge in major markets like Europe, the United States or China, where each country has a pivotal role in how it conducts digital transactions and the methods of cyber security it uses. Representatives of the AmCham Digital Business Committee had many questions about how data protection is implemented in international transactions, the challenges that the future will bring for a small country like Albania aspiring to join the Europen Union, unifying its rules to those of the bloc.

The issue of taxes applied to online sales, especially to those from e-commerce giants like Amazon, eBay or Google, was also a topic discussed during the meeting.

Speaking of valuable experiences to be exchanged, Digital Business Committee Chairman Achilleas Kanaris, opened a discussion on how the Committee should approach e-commerce and all the regulatory systems that regulate it. The issues related to e-commerce development needs must come from markets, important sectors, products in circulation, and most of all, consumer needs.




BORDI DHE KOMITETI I BIZNESIT DIGJITAL, MËNGJES PUNE ME
**PËRFAQËSUESIN E DHOMËS AMERIKANE NË UASHINGTONIT**

# Mbrojtja e të dhënave dhe digjitalizimi i ekonomisë në fokus të diskutimit

Menaxheri për Politikat Ndërkombëtare në Ekonominë Digjitale në Dhomën Amerikane në Uashington, z. Evangelos Razis, ka vizituar Shqipërinë në kuadrin e konferencës ndërkombëtare mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe takimin e parë të punës e ka patur me Bordin Drejtues të AmCham dhe anëtarët e Komitetit të Biznesit Digjital. Takimi ka shërbyer si një bazë e mirë e network-ut dhe shkëmbimit të informacioneve mbi punën që bën Dhoma Amerikane, për të orientuar bizneset drejt zhvillimeve digjitale si dhe për t'i dhënë atij një informacion të përditësuar mbi ndryshimet ligjore që pëson ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

Z. Razis duke prezantuar punën që bën Dhoma Amerikane në Uashington dhe departamenti që ai drejton, ka folur për hartimin e politikave mbi digjitalizimet në ekonomi, zhvillimet në sektorin privat, rregullat standarde dhe proceset rregullatore në lidhje me mbledhjen dhe procedimin e të dhënave në një ekonomi globale. Inteligjenca artificiale, është novacioni mbi të cilin AmCham Uashington dhe departamentet që merren me politikat digjitale kanë kthyer kokën dhe po tregojnë interes të veçantë. Z. Razis ishte i mendimit se pjesëmarrja në Konferencën për Mbrojtjen e të Dhënave, është një moment i mirë për të ndërvepruar me kolegë nga AmCham-et e tjera dhe për të folur për punën që po bëhet për të ndërtuar legjislacione që do të kontrollojnë dhe sigurojnë veprimtarinë e biznesit dhe të qeverive kur vjen fjala për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave.

Presidenti i AmCham Albania, z. Enio Jaço, ka vlerësuar takimin dhe ka vendosur theksin në faktin se Dhoma sapo ka krijuar një Komitet që i përgjigjet nevojave të zhvillimit digjital, duke bashkëpunuar me ekspertët më të mirë të fushës. "Do të jetë ky Komitet që do të orientojë jo vetëm edukimin e sektorit privat mbi zhvillimet digjitale, por dhe do të ketë rol udhëheqësi në proceset për formatimin e ligjeve koherente që e zhvillojnë këtë proces" – u shpreh z. Jaço.

Anëtarët e Dhomës Amerikane kanë patur mjaft për të biseduar









me z. Razos në lidhje me legjislacionin që zbatohet në Amerikë për mbrojtjen e të dhënave, mënyrën se si lidhen marrëveshjet tregtare lokale dhe globale, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave si dhe rolin e qeverisë në këto zhvillime. "Cyber Security" ishte një tjetër temë e preferuar, duke patur parasysh riskun e lartë të komunikimeve elektronike dhe formave të zhvillua të e-commerc-it sot në gjithë botën. Nevoja për një unifikim të ligjeve dhe ratifikime marrëveshjesh ndërkombëtare që do të unifikonin praktikat e mbrojtjes së të dhënave, është ngritur nga Drejtori Ekzekutiv i Dhomës Amerikane, z. Ilir Trimi, i cili ka hapur një temë diskutimi mbi kompleksitetin e marrëdhënieve tregtare që zhvillohen on-line.

Ndërsa Shqipëria është një pjesë e vogël që lufton për të kapur sfidat e kohës, marrëdhëniet që rregullohen mbi bazën e GDPR-it janë bërë të forta dhe të komplikuara. Kjo duhet në marrëdhëniet që krijohen në tregje të mëdha si Europa, Amerika apo Kina, ku secili ka një rol themelor në mënyrën se si i kryen transaksionet digjitale dhe format e sigurisë kibernetike që përdor. Përfaqësuesit e Komitetit të Biznesit Digjital kanë patur shumë pyetje në lidhje me mënyrën se si zbatohet Mbrojtja e të Dhënave në transaksionet ndërkombëtare, sfidat që do të sjellë e ardhmja për një vend të vogël si Shqipëria që synon të bëhet pjesë e BE-së dhe të njehësojë rregullat.

Çështja e taksave që aplikohet nga shitjet on-line, sidomos në portalet e gjikandëve të e-commerce-it si Amazon, e-Bay apo Google, ka qenë gjithashtu një temë e diskutuar gjatë takimit. Duke folur për eksperincat e vlefshme që mund të shkëmbenin me njëri-tjetrin, kreu i Komitetit të Biznesit Digjital, z. Achilleas Kanaris, hapi diskutimin e mënyrës se si ky Komitet duhet të përqasë e-commerce-in dhe gjitha sistemet rregullatore që e rregullojë atë. Çështjet për zhvillimet e e-commerce-it duhet të vijnë nga tregjet, sektorët që kanë rëndësi, produktet që qarkullojnë, dhe mbi të gjitha, nga nevojat e konsumatorëve.






# Amcham Washington and Amcham Albania

## Global developments, data governance and technology innovation

The technological innovations of ITI's members, and the digitalisation of the economy more broadly, brings innumerable benefits to European industries and societies. The tech sector empowers European companies of all sizes and across industries – from agriculture to education, from financial services to manufacturing and energy, to healthcare and transportation – to leverage frontier innovations to compete and succeed in the global marketplace.

Convinced that technology to addresses some of the most socially challenging issues of the time and improve the quality of daily life, EU governing institutions are working to prepare the legislation that will support these technological developments. A general overview of the work being done to regulate data governance laws and procedures, including data protection and their innovation and security, was discussed at the meeting organized by the AmCham in Washington and the American Chamber in Tirana. Senior officials from different countries, representing committees and institutions directly, as well as from the State Department and Mr. Evangelos Razis of AmCham Washington related to global data protection policies and technological developments.

The meeting focused on how it is proceeding to key markets in the EU and US to protect data in a global market. Europe has developed an extensive framework for privacy and the General Data Protection Regulation is having a global impact on many governments' efforts to update their own privacy legislations and enable their businesses to trade more easily within European market. These developments will help foster the trust of consumer and business in digital products and services, that is critical to the adoption of new technology in the EU. The Implementation of the data protection framework should focus on deep harmonization within the EU, and flexibility to take into account the ongoing tech evolution , allowing the EU to meets the needs of individuals, businesses and society and innovate across many industries, in unprecedented ways, from revolutionizing the delivery of healthcare, to facilitate a new wave of modern conveniences while ensuring privacy rights are safeguarded.

During the meeting was emphasized the fact that consumer rights in the market rules and market players is cricial. Ensuring consumers' access to the control over their personal data is key to encourage them to trust that data will be used transparently, leading to increased consumer welfare in the form of better, more relevant and innovative products and services at lower price or free of charge. Only in this way, strong privacy protections will not be at odds with innovation.






# AmCham Uashington dhe AmCham Albania

## Zhvillimet globale, qeverisja e të dhënave dhe inovacioni në teknologji

Risitë teknologjike dhe digjitalizimi i ekonomisë, sjellin përfitime të panumërta për industritë dhe vendet e BE-së dhe ato në zhvillim. Sektori i teknologjisë është kthyer sot në një mbështetje për kompanitë e të gjitha madhësive dhe në të gjitha industritë - shërbimet financiare, arsim, bujqësi, kujdesin shëndetësor apo transportin, për të nxitur konkurrencën dhe për të patur sukses në tregun global.

Të bindur se teknologjia lejon të adresojmë disa nga çështjet më sfiduese shoqërore të kohës dhe të përmirësojmë cilësinë e jetës së përditshme, institucionet drejtuese të BE-së janë duke punuar për të përgatitur bazën legjislative që do të mbështesë këto zhvillimeve teknologjike. Një këndvështrim të përgjithshëm të punës që po bëhet për të rregulluar me ligje dhe procedura qeverisjen e të dhënave, brenda të cilave qëndrojnë nocione të mbrojtjes së të dhënave, zhvillimeve teknologjike dhe novacionit dhe sigurisë së tyre, është folur në takimin e organizuar nga Dhoma Amerikane në Uashington dhe Dhoma Amerikane në Tiranë. Në takim kanë referuar zyrtarë të lartë nga vende të ndryshme, të cilët përfaqësojnë komisione dhe institucione që lidhen drejtpërdrejt me politikat globale të mbrojtjes së të dhënave dhe zhvillimeve teknologjike, si edhe nga Departamenti i Shtetit dhe z. Evangelos Razis nga AmCham Uashington.

Gjatë takimit është folur për mënyrën se si po procedohet në tregjet kryesore në BE dhe SHBA për të mbrojtur të dhënat në një treg global. Evropa ka zhvilluar një kornizë të gjerë për privatësinë dhe Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave ka një ndikim global në përpjekjet e shumë qeverive për të azhornuar legjislacionin e tyre të privatësisë dhe për t'i lejuar bizneset e tyre të tregtojnë më lehtë me tregjet evropiane. Këto zhvillime do të ndihmojnë në nxitjen e besimit të konsumatorëve dhe bizneseve në produktet dhe shërbimet digjitale, që është thelbësore për miratimin e një teknologjie të re në BE. Zbatimi i kornizës së mbrojtjes së të dhënave duhet të përqendrohet në harmonizimin e thellë brenda BE-së, dhe fleksibilitetin për të marrë parasysh evolucionin e vazhdueshëm të teknologjisë, duke lejuar BE-në të përmbushë nevojat e individëve, bizneseve dhe shoqërisë dhe të inovojë në shumë industri, duke revolucionarizuar ofrimin e kujdesit shëndetësor, për të lehtësuar një valë të re të komoditeteve moderne, duke siguruar që të drejtat e intimitetit të jenë të mbrojtura. Gjatë takimit u theksua fakti se besimi i konsumatorit në rregullat e tregut dhe aktorët e tregut është thelbësor. Sigurimi i qasjes dhe i kontrollit të konsumatorëve mbi të dhënat e tyre personale është thelbësor për t'i inkurajuar ata të besojnë se të dhënat do të përdoren në mënyrë transparente, duke çuar në rritjen e mirëqenies së konsumatorit në formën e produkteve dhe shërbimeve më të mira, më të rëndësishme dhe më inovative, me çmime më të ulëta ose falas. Vetëm në këtë mënyrë, mbrojtjet e forta të privatësisë nuk do të jenë në kundërshtim me inovacionin.












# Tirana Tech Open

## AmCham ED introduces audience to our renewed focus on digitalization

Tirana Tech Open, organized by Expo City, opened its doors for entrepreneurs, investors, institutions, startups, students and teachers to discuss the latest trends in innovation, education and investment.

Tirana Tech Open has set up different profiles to engage future startup entrepreneurs with the aim of promoting investment and digitization in entrepreneurship and social development.

About 28 guests from different parts of the world led mini-activities, attended by 2900 visitors over the course of the three-day event.

AmCham Executive Director Ilir Trimi was also part of the event, and included referred in his presentation how the American Chamber of Commerce in Albania is working through its community to promote developments in the area of technology and digitalization.

> AmCham is giving an effort to promote the benefit of **digitalization to his members and to have an impact on economy.**

Speaking about digitalization Mr Trimi said " The application of digital technologies to your business could mean the difference between success and failure. Digital innovation and the introduction of disruptive technologies are no longer used to give you and edge so that you can better compete, they have become a necessity in order to survive. Growing young populations have fundamentally changed the way we do business and how consumers access goods and services within countries and across borders"

AmCham is promoting the benefits of digitalization to it's members and how to have an impact on company growth.

"We at the American Chamber of Commerce recognize the potential of digitalization and believe the business community needs guidance and assistance, that's why we have recently created the Digital Business Committee" – said Mr.Trimi during his speech.

The Digital Business Committee will focus on important topics such as, e-signature Digital Skills for SMEs. Enhance and promote digital commerce, and will serve our members in three ways, through advocacy, networking and professional development.






# Tirana Tech Open

## Drejtori i AmCham prezantoi **audiencën me fokusin e** shtuar mbi digjitalizimin

Tirana Tech Open" e organizuar nga Expo City hapi dyert për sipërmarrës, investitorë, institucione, start up-e, studentë dhe mësues, për të folur rreth tendencave të fundit në Inovacion, Arsim dhe Investime. Tirana Tech Open ka patur profilet e veta të konceptuara mbi bazën e angazhimit të sipërmarrësve start up-eve, studentëve, të gjitha në funksion të promovimit të inovacionit dhe digjitalizimit në sipërmarrje dhe zhvillimet sociale.

Rreth 28 të ftuar nga disa vende të botës kanë qenë pjesë e këtyre miniorganizimeve, të cilët për gjatë tre ditëve janë ndjekur nga 2900 vizitorë. Pjesë e këtij eventi ka qenë edhe Dhoma Amerikane nëpërmjet Drejtorit Ekzekutiv, z. Ilir Trimi, i cili ka referuar për mënyrën se si Dhoma Amerikane po punon nëpërmjet komunitetit të saj, për të promovuar zhvillimet në fushën e teknologjisë dhe digjitalizimit.

> AmCham është duke u përpjekur të promovojë **përfitimin e digjitalizimit për anëtarët e saj dhe të ketë një ndikim në ekonomi.**

Duke folur për digjitalizimin, z. Trimi tha se "Zbatimi i teknologjive digjitale në biznesin tuaj mund të nënkuptojë ndryshimin midis suksesit dhe dështimit. Inovacioni digjital dhe futja e teknologjive konkurruese nuk përdoren më për t'ju dhënë përparësi, në mënyrë që të konkurroni më mirë, ato janë bërë një domosdoshmëri për të mbijetuar. Rritja e popullsisë ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si ne bëjmë biznes dhe se si përdoruesit i qasen mallrave dhe shërbimeve brenda vendeve dhe përtej kufijve".

AmCham është duke u përpjekur të promovojë përfitimin e digjitalizimit për anëtarët e saj dhe të ketë një ndikim në ekonomi.

"Ne në Dhomën Amerikane të Tregtisë njohim potencialin e digjitalizimit dhe besojmë se komuniteti i biznesit ka nevojë për orientim dhe ndihmë, kjo është arsyeja pse ne kemi krijuar kohët e fundit Komitetin e Biznesit Digjital" - tha z. Trimi gjatë fjalës së tij. Komiteti i Biznesit Digjital do të përqendrohet në tema të rëndësishme siç janë, Novacionet digjitale e-signature, promovimi i e-commerce dhe do t'u shërbejë anëtarëve tanë në tre mënyra - përmes avokimit, network-ut dhe zhvillimit profesional.





# Annual Conference of Best Practices

## AmChams in Europe discuss best practices in Belgrade



The Best Practices Conference for American Chambers of Commerce in Europe is traditionally organized and hosted by one of the European chambers and focuses on facilitating the exchange of best practices and discussing relevant issues affecting AmChams and their members. For the host AmCham, this is an opportunity to showcase their country and expose its members to the AmCham network.

This year's event was hosted by AmCham Serbia in Belgrade. The three-day conference dealt with issues that come up often for AmChams and their staff during work. The event also featured a novelty with the issuing of the first AmCham Best Practice Award. Best practices are defined as great initiatives that have boosted AmCham operations with innovative ideas. These are then shared with the other organizations. Five countries competed with their best practices and ultimately AmCham Belgium came up on top, winning the award.

AmCham executive directors attending the meeting also discussed how they conduct their day-to-day activities and key leadership elements needed for AmChams. Events, advocacy, memberships, communications and sponsorships were issues extensively discussed at the meeting of AmCham leaders and staff from all over Europe. They brought their experiences on how to solve issues at hand, including what to take under consideration when working to develop and grow memberships as well as how to have consolidated budgets.

The meeting also had the aspect of network development and entertainment. AmCham staff and executives in Europe used the opportunity to visit historic and cultural centers and venues in Belgrade.

*Established in 1963, AmChams in Europe serves as an umbrella organization for the 45 American Chambers of Commerce (AmChams) from 43 countries across Europe and Eurasia. In Europe, we represent the interests of more than 17,000 U.S. and European companies, employing 20 million people, and account for more than $1.1 trillion in investments on both sides of the Atlantic.*



# Konferenca Vjetore e Praktikave më të mira

## Dhomat Amerikane në Evropë flasin për praktikat më të mira në Beograd



Konferenca vjetore "Praktikat më të mira" e Dhomave Amerikane në Evropë organizohet tradicionalisht nga një anëtar i AmCham-eve të Evropës dhe përqendrohet në lehtësimin e shkëmbimit të praktikave më të mira dhe diskutimin e çështjeve përkatëse që prekin AmCham-et dhe anëtarët e tyre. Për AmCham-in pritës, kjo është një mundësi e mirë për të treguar vendin e tij dhe për të ekspozuar e anëtarët e tij në rrjetin AmCham-eve.

Këtë vit, ky event u organizua nga AmCham Serbia në Beograd. Konferenca tre ditore ka sjellë tema të aktivitetit të përditshëm që bëjnë stafet e AmCham-eve për të zhvilluar organizatën e tyre, por dhe ka patur risinë e dhënies së çmimit për AmCham-in që ka sjellë praktikën më të mirë. "Praktika më e Mirë" është konsideruar si një si një iniciativë e shkëlqyer që stimulon AmCham-et të punojnë me ide novatore dhe t'i ndajnë ato edhe me organizatat e tjera. Pesë vende kanë konkurruar me praktikat e tyre më të mira dhe në fund fitues është shpallur AmCham Belgjika.

Gjatë takimit, Drejtorët Ekzekutivë të Dhomave Amerikane kanë folur dhe për mënyrën se si zhvillojnë në aktivitetin e përditshëm elementët kryesorë të drejtimit të organizatës. Aktivitetet, politikat avokuese, anëtarësia, komunikimi dhe sponsorizimet, kanë qenë çështje që janë trajtuar gjerësisht nga drejtuesit dhe stafet e Dhomave Amerikane prezente në takim. Ata kanë sjellë eksperiencat e tyre se si i zgjidhin çështjet që iu dalin në punën e tyre, çfarë duhet të kenë në konsideratë, si punojnë për të zhvilluar anëtarësinë si edhe për të patur buxhete të konsoliduara.

Takimi ka trajtuar edhe aspektin e zhvillimit të *network*-ut dhe argëtimit. Stafet dhe drejtuesit e AmCham-eve në Evropë kanë vizituar qendra dhe vende historike e kulturore të Beogradit.

*Themeluar në vitin 1963, AmCham Evropë shërben si organizatë ombrellë për 45 Dhomat e Tregtisë Amerikane (AmChams) nga 43 vende në të gjithë Evropën dhe Euroazinë. Në Evropë ne përfaqësojmë interesat e më shumë se 17,000 kompanive amerikane dhe evropiane që punësojnë 20 milion punonjës dhe që përbëjnë më shumë se 1.1 trilion dollarë në investime nga të dy anët e Atlantikut.*






*During World War I, a group of Americans came to Albania to offer logistical assistance to army units stationed in Korça. After the war ended in 1918, some of them did not leave but remained in Albania and settled in Tirana where they helped to open an orphanage. They took photos of their travels and activities in Albania, and these rare and previously unexplored photos were featured at the networking event organized by AmCham.*



**100 YEARS OF HISTORY:** ALBANIAN-AMERICAN RELATIONS IN PICTURES

# Back to Work event brings together AmCham members

With the summer season over, AmCham member businesses are not only back to work in full gear, and during the "Back to Work" event had the opportunity to hear about ambitious programs of AmCham. To discuss plans ahead and to network, AmCham organized event, bringing together members in a unique setting. The networking event had as a backdrop of a photo exhibition of Americans' living in Albania after World War I, celebrating 100 years of Albanian-American history. AmCham President Enio Jaço welcomed members to the event and praised the cooperation and networking opportunities the organization offers -- Back to Work being one of several formats available. In his remarks to members, Mr. Jaço emphasized that AmCham is working to build ambitious programs that will help members with training and development.

"The ties and relationship between Albania and the United States are at the core of AmCham's work, and we work every day to promote this relationship and the history that appears in these 100-year-old photographs, which show how far back our relation goes," AmCham President Enio Jaço said in his remarks. The key attraction at the event were old photographs on display, evoking Albania's dealings with Americans, dating back to 1918-1920. Auron Tare, the Albanian-American scholar and historian, spoke about these photographs, their origin and history, and brought details of the activity of Americans in Albania at the time. In his remarks about the history of the photos, Mr. Tare explained that they go back to the origins of many institutions in Albania founded as a result of the work of American institutions, such as the "Harry Fultz" Educational Institution, the country's first orphanage, etc.

> The key attraction at the event were **old photographs on display, evoking Albania's dealings with Americans, dating back to 1918-1920.**





**100 VJET HISTORI** MARRËDHËNIE SHQIPTARO- AMERIKANE NË FOTO

# 'Back to Work' mbledh së bashku anëtarët e AmCham

*Në luftën e Parë Botërore një grup amerikanësh erdhën në Shqipëri për të ndihmuar me logjistikë ushtrinë e tyre që ishte vendosur në Korçë. Pas mbarimit të luftës në 1918-ën, një pjesë e tyre nuk u larguan, por mbetën në Shqipëri dhe u vendosën në Tiranë ku ndihmuan për të hapur Shtëpinë e Fëmijës. Ata kanë bërë foto nga udhëtimet dhe veprimtaria e tyre në Shqipëri, dhe këto foto të rralla dhe të paekspozuara më parë, u shfaqën në network-un e organizuar nga Dhoma Amerikane.*

Back to Work' ka mbledhur anëtarët, të cilët pas sezonit veror rikthehen fuqishëm jo vetëm në bizneset e tyre, por edhe në programet ambicioze të Dhomës Amerikane. Network-u pati në sfond ekspozitën me foto nga jeta e amerikanëve në Shqipërinë e mbas Luftës së Parë Botërore që celebron 100 vjet histori shqiptaro- amerikane.

Presidenti i AmCham-it, z. Enio Jaço, ka përshëndetur anëtarët dhe ka vlerësuar format e bashkëpunimit dhe të netëork-ut që organizata mundëson, dhe 'Back to Work' është pikërisht një nga ato formate që i shërben këtij qëllimi. Z. Jaço në komunikimin e tij me anëtarët, ka theksuar se Dhoma Amerikane po punon për të ndërtuar programet ambicioze që i shërbejnë trajnimit dhe zhvillimit të anëtarëve. "Lidhja dhe marrëdhënia mes Shqipërisë dhe SHBA-së është në themel të punës së Dhomës Amerikane dhe ne punojmë çdo ditë për të promovuar këtë marrëdhënie dhe histori që shfaqet dhe në këto fotografi 100 vjecare dhe tregojnë se sa të hershme janë marrëdhëniet tona" – u shpreh gjatë fjalës së tij Presidenti z. Enio Jaço.

Si element interesant i këtij aktiviteti ishin dhe fotot e vjetra të ekpozuara që evokojnë raportet me amerikanët dhe datojnë në vitet 1918-1920. Mbi këto fotografi, origjinën dhe historinë e tyre, ka folur z. Auron Tare, studiuesi dhe historiani shqiptaro - amerikan, i cili ka sjellë detaje nga aktiviteti i amerikanëve në Shqipërinë e asaj kohe. Duke folur mbi historinë e fotove, z. Tare ka shpjeguar zanafillën e shumë institucioneve të krijuara në Shqipëri si rrjedhojë e punës së amerikanëve, si institucioni arsimor "Harry Fultz", Shtëpia e parë e Fëmijës etj.

> Si element interesant i këtij aktiviteti ishin dhe **fotot e vjetra të ekpozuara që evokojnë raportet me amerikanët dhe datojnë në vitet 1918-1920.**

# CBS Launches Digital Platforms on 5th Anniversary establishment




**The event adopted the business-after-hours AmCham model**

The introduction of five digital platforms that provide long-term solutions to key sectors of the economy, brought together 300 participants from the business community, as well as high ranking officials, experts and international donors.

On September 26, 2019, Creative Business Solutions (CBS) held its first annual event entitled 'Growth Together'. The event adopted the business-after-hours model that helps to promote AmCham members to its audiences and beyond, leading to better cooperation.

As a response to the invitation for stronger partnerships, attending the event were representatives of CBS's strategic partners like USAID, EU, World Bank, GIZ, SIDA, etc. as well as banking and financial institution executives, experts, donors and investors. All joined in to explore how to develop their businesses and various projects through these platforms. These digital products set up by CBS and its partners have had an impact on the growth of 3,000 businesses with a revenue capital of 43 million USD or 100,000 USD in revenues for each of the partner businesses. Furthermore, the products have boosted investments and delivered new job openings aimed at sustainable development for these companies. In his remarks, the founder and CEO of CBS, Enio Jaço, welcomed all participants and underlined the importance of partnerships in such projects.

"Our platforms are already active and this represents a major change for CBS. We began by designing products that offer sustainable solutions. We are open to sharing these products with everyone that is interested in increasing investment in their business activities" he said.



Eventi ishte pjesë e formatit **"Biznes pas Pune"** në Dhomën Amerikane

# CBS përuron 5 Platformat Digjitale në 5 Vjetorin e krijimit

> Platformat tona janë tashmë aktive dhe kjo përfaqëson një ndryshim madhor për CBS-in. Ne filluam nga dizenjimi i produkteve që ofrojnë një zhvillim të qëndrueshëm. Ne jemi të hapur për t'i ndarë këto produkte me këdo që është i interesuar të rrisë investimet në aktivitetin e tij të biznesit.

Prezantimi i pesë platformave digjitale që i japin zgjidhje afatgjata disa prej sektorëve kyç të ekonomisë, mblodhi bashkë në Tiranë, 300 pjesëmarrës nga sektori i biznesit dhe institucione të rëndësishme financiare ndërkombëtare. Creative Business Solutions (CBS) organizoi më datë 26 shtator 2019, Eventin e Parë Vjetor, "Growth. Together". Natyra e këtij eventi ishte "Biznes pas Pune", si model që promovon anëtarë të Dhomës Amerikane brenda dhe jashtë audiencës së saj, me qëllim bashkëpunimin mes tyre. Fokus i këtij takimi ishte prezantimi dhe hapja e pesë platformave inovative, digjitale të krijuara nga CBS, si urë lidhëse për bizneset dhe mundësitë e përbashkëta.

Si përgjigje e ftesës për një partnership më të fortë, pjesëmarrësit në këtë event ishin partnerë strategjikë të CBS si USAID, BE, Banka Botërore, GIZ, SIDA, etj., përfaqësues të lartë ekzekutivë bankash, institucione financiare, ekspertë, donatorë dhe investitorë. Të gjithë u bashkuan për të eksploruar si të zhvillojnë bizneset e tyre dhe projekte të ndryshme përmes kësaj platforme.

Produktet digjitale të krijuara nga CBS dhe partnerët, kanë ndikuar në rritjen e rreth 3 mijë bizneseve, me një kapital të ardhurash prej 43 milionë USD në total, apo 100 mijë USD të ardhura të reja për secilin nga bizneset partnere. Për më tepër, këto produkte kanë promovuar investime dhe kanë ndihmuar për të hapur vende të reja pune me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre kompanive. Themeluesi dhe Drejtori Ekzekutiv i CBS-it, z. Enio Jaço, njëkohësisht President i Dhomës Amerikane të Tregtisë, duke falenderuar të gjithë pjesëmarrësit për interesin e lartë tha:

"Platformat tona janë tashmë aktive dhe kjo përfaqëson një ndryshim madhor për CBS-in. Ne filluam nga dizenjimi i produkteve që ofrojnë një zhvillim të qëndrueshëm. Ne jemi të hapur për t'i ndarë këto produkte me këdo që është i interesuar të rrisë investimet në aktivitetin e tij të biznesit".




## AgroWeb.org

### AGROWEB WITH TWO NEW INFORMATIVE PAGES

AgroWeb, the ultimate online communication tool on healthy living, reaches 2 million people a month. The platform has over 351,000 followers on Facebook and is the most popular page for Albanians in the country and abroad. AgroWeb will be expanded as an online media platform with the launch of two new informative websites. Smart Life by AgroWeb and Health by AgroWeb will aim to increase the quality of life, wellbeing and health.

### SË SHPEJTI ME DY FAQE TË REJA INFORMATIVE

AgroWeb, ky mjet i komunikimit on-line mbi jetesën e shëndetshme, arrin plot 2 milionë njerëz në muaj. Platforma ka mbi 351,000 ndjekës në Facebook, dhe është faqja më popullore për shqiptarët brenda dhe jashtë Shqipërisë. AgroWeb do të vijojë zgjerimin e tij si platformë mediatike on-line, me hapjen e dy faqeve të reja informative. Smart Life nga AgroWeb dhe Shëndet nga AgroWeb, të cilat synojnë rritjen e cilësisë së jetesës, gjithashtu dhe kujdesin ndaj shëndetit.




## IntoAlbania

### INTOALBANIA, A ONE-STOP PLATFORM FOR TOURISTS

IntoAlbania is a digital one-of-a-kind product that provides authentic experiences for foreigners in Albania. Tourists who want to visit Albania can use the platform to buy airline tickets, book accommodation, discover the right attractions, restaurants, bars, tours, etc. Nearly 45,000 tourists who used the platform have visited Albania and over 100 small and medium enterprises use the platform for their transactions. At the core of IntoAlbania is its e-commerce function that brings Albanian businesses closer to international customers.

### INFORMACION DHE TRANSAKSIONE, GJITHÇKA PËR TURISTËT NË NJË FAQE

IntoAlbania, është një platformë digjitale e vetmja e llojit të vet që iu ofron përvoja autentike të huajve në Shqipëri. Turistët që vizitojnë Shqipërinë mund ta përdorin plarformën për të blerë biletën e avionit, të prenotojnë qëndrimin, të zbulojnë atraksionet e duhura, restorantet, baret, turet, etj. Afërsisht 45 mijë turistë, të cilët kanë përdorur platformën kanë vizituar Shqipërinë dhe mbi 100 SME kanë kryer transaksione nëpërmjet faqes. IntoAlbania mbart në bërthamën e platformës së saj funksionin E-Commerce, i cili ndihmon afrimin e bizneseve shqiptare me klientë të huaj.




## AgroTrade

### AGROTRADE – A BRIDGE BETWEEN PRODUCERS AND FOREIGN BUYERS

AgroTrade is an online B2B platform that connects businesses in the agriculture sector with regional and international markets, with integrated 360-degree trading procedures. The platform facilitates communication, promotion and visibility for Providers, while reducing the time consuming process for Product Seekers. AgroTrade aims to become a regional leader in providing export-ready companies with the opportunity to expand in international markets.

### NJË URË LIDHËSE MIDIS PRODHUESVE SHQIPTARË DHE BLERËSVE TË HUAJ

AgroTrade është një platformë on-line B2B që lidh kompanitë operuese në fushën e bujqësisë me tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, me procedura të integruara të tregtimit 360°. Platforma lehtëson komunikimin, promovimin dhe paraqitjen për shitësit, ndërkohë që redukton kohën për blerësit. AgroTrade synon të bëhet lideri rajonal në ofrimin e kompanive të gatshme për eksport me mundësinë për t'u zgjeruar në tregjet ndërkombëtare.

### I3 - CBS's latest innovative product

# A NEW INVESTMENT FUND WITH SOCIAL AND ENVIRONMENT IMPACT

We will provide our assistance to companies receiving grants or technical assistance. We will look into the possibility of financing large and small enterprises, which want to invest in sustainable agriculture, renewable energy, tourism, health, education, etc" Mr. Jaço said

It is called the Impact Investing Initiative. A global trend that emerged 12 years ago, in 2007, today a $500 billion industry.

**CBS BRINGS IT TO ALBANIA FOR THE FIRST TIME.**

At the conclusion of the event, the CEO of CBS, Enio Jaço, presented the latest product that CBS will deliver soon - called Impact Investing Initiative, or I3 - and is expected to be launched by the end of 2020.

The project aims to create an equity fund (grants) for investments that will have a positive social and environmental impact on the country, in addition to financial benefits.

"We will provide our assistance to companies receiving grants or technical assistance. We will look into the possibility of financing large and small enterprises, which want to invest in sustainable agriculture, renewable energy, tourism, health, education, etc" Mr. Jaço said.

## LORES,

### digital loan referral system

LORES is an online platform that collects and processes data from agribusinesses, structures it in an appropriate format for credit decisions and sends it electronically to banks. Only three months after being launched by CBS, five of Albania's largest banks embraced LORES. Until now the platform has helped to disburse 215 loans worth $6.5 million, with another $13 million in the disbursement process.

CBS will soon launch LORES 2.0, which brings innovation to its function in three ways.

**First,** LORES 2.0 will be open and clients can apply directly into the system.

**Second,** the platform will open to External agents for referrals, who will receive commissions for each successful loan.

**Third,** for bankers, LORES will provide financial novelty that lowers the risk of loans, providing cheaper fees for clients.

### I3 Nisma e Re e CBS, për produktet inovative

# NJË FOND I RI INVESTIMI ME IMPAKT SOCIAL DHE MJEDISOR

Ne do të ofrojmë ndihmën tonë që kompanitë të marrin grante ose asistencë teknike. Ne do të shohim mundësinë e financimit të Sipërmarrjeve të Mëdha e të Vogla, të cilat duan të investojnë në bujqësinë e qëndrueshme, energjinë e rinovueshme, turizëm, shëndetësi, arsim etj." - u shpreh z. Jaço

Quhet Impact Investing Initiative. Një fenomen global që lindi 12 vjet më parë në 2007-ën, dhe sot është një industri 500 miliardë dollarëshe.

**CBS, E SJELL PËR HERË TË PARË NË SHQIPËRI.**

Në mbyllje të eventit, Drejtori Ekzekutiv i CBS, z. Enio Jaço prezantoi produktin e ri të cilin CBS-i do ta paraqesë së shpejti i quajtur - Impact Investing Initiative ose I3 dhe pritet të lançohet nga fundi i 2020-ës.

Projekti synon krijimin e një fondi me kapital (grante) për investime që do të kenë ndikim pozitiv, social dhe mjedisor në vend, krahas përfitimeve financiare.

"Ne do të ofrojmë ndihmën tonë që kompanitë të marrin grante ose asistencë teknike. Ne do të shohim mundësinë e financimit të Sipërmarrjeve të Mëdha e të Vogla, të cilat duan të investojnë në bujqësinë e qëndrueshme, energjinë e rinovueshme, turizëm, shëndetësi, arsim etj." - u shpreh z. Jaço.

## LORES,

### platforma digjitale e referimit të kredive

LORES, një platformë që grumbullon, proceson të dhënat e agrobizneseve, i strukturon ato në formatin e duhur dhe ua dërgon bankave elektronikisht në një format të strukturuar, gati për vendime kreditore. Vetëm 3 muaj pas lançimit, 5 nga bankat më të mëdha përqafuan menjëherë LORES. Deri tani platforma ka ndihmuar në disbursimin e 215 kredive me një vlerë prej 6.5 milionë dollarë, ndërsa 13 milionë dollarë të tjera janë në proces disbursimi. CBS së shpejti do të lançojë fazën e dytë të këtij produkti, LORES 2.0, i cili sjell risi në funksionimin e tij në tre mënyra.

**Së pari,** me LORES 2.0 sistemi do jetë i hapur dhe çdo klient mund të aplikojë direkt në sistem.

**Së dyti,** LORES do hapet për referime edhe për ekspertët e jashtëm, të cilët do fitojnë një komision për çdo kredi të suksesshme.

**Së treti,** për bankierët: LORES do ofrojë një inovacion financiar që do t'i bëjë kreditë me risk më të ulët, por dhe me çmim më të ulët për klientin.



# member news

Philip Morris Albania recently premiered in the country its UNSMOKE initiative. Through this initiative -- introduced in a presentation at the premises of the Center for Opening and Dialogue (COD) -- the world's leading tobacco company aims to spread a simple message, which is also a reflection of some of its key corporate positions: if you don't smoke, don't start; if you do smoke, quit and if you don't, change. #Unsmokeyourworld is a Philip Morris International initiative to speed up a landmark change in public health toward a future where cigarettes will no longer be used. The #unsmoke movement aims to create a community of people who can accelerate this change. It reinforces the message that quitting cigarettes and nicotine altogether is the best choice any smoker can make and for those adult smokers who would otherwise continue to smoke, a reasonable plan is needed. It calls for these men and women to be given access and information about the scientifically-based alternatives that innovation and technology have enabled.

Anis Brahimaj of Philip Morris Albania spoke about the importance of implementing UNSMOKE in Albania and its public spaces. "Albania has a high prevalence of smokers who could benefit from an initiative that has reached over 1 million internet sign-ups worldwide," she said.

Attendees became more familiar with the UNSMOKE campaign through the explanation of Philip Morris International's representative from Lausanne, Mario Moniz Barreto, of the genesis of this initiative and its global development.

Mr. Barreto said: "Unsmoke is an initiative that wants to accelerate the rate at which smoking will decline. We encourage adults who do not smoke not to start, or if they do, to quit. If not, consider switching to smoke-free alternatives."

Mr. Moniz Barreto also added: "After decades of education, prevention and cessation policies, there are still more than a billion adult smokers in the world. We believe we can help address this global public health problem with joint efforts from the public and private sectors."

Meanwhile, Professor Edmond Dragoti, a sociologist and psychologist, introduced the participants to human behavior trends and how important the positive examples are in embracing new initiatives.

"People are often prone to act in a way that is harmful to themselves, their loved ones and their environment. But they usually do not give up on this behavior easily because they will always find a way to rationalize their choices. For these people the concept of 'risk reduction' is much better than the 'zero tolerance"'approach. Give people sun protection on the beach, give smokers alternatives, give stevia to diabetics and you'll save more lives than banning options," he said.

At the end of the event, six photo stories from a smokeless daily life were featured at a special corner of COD to share the personal messages and stories of those who have managed to change their lives for the better.

**About Philip Morris International: Securing a Smokeless Future**

Philip Morris International (PMI) is leading a transformation in the tobacco industry to create a smoke-free future and eventually replace cigarette smoke-free products for the benefit of adults who otherwise would continue to smoke. PMI is a leading international tobacco company engaged in the manufacture and sale of cigarettes, smoke-free products and electronic accessories as well as other nicotine-containing products in markets outside the United States. PMI is building a future in a new category of smoke-free products that, while not harmless, are a much better choice than traditional cigarettes. Through its multidisciplinary product development and advanced science capabilities, PMI aims to ensure that smoke-free products meet adult consumer requirements and stringent regulatory requirements.

Gallery 70 Contemporary Art was pleased to present Jon Kraja's personal exhibition. The exhibition consists of paintings on acrylic and two sculptures made from recycled materials, from artist's latest cycles. Jon Kraja brings his personal quest for beauty to a consumerist and over polluted world. If in his paintings he finds beauty in the rapid casting of colors and the unpredictability created in the collision between them, in the sculptures he researches the sensitivity of the shapes resulting from the deformation of plastic bottles, a process of hand manipulation that the artist conducts himself . The end result of the process of transformation, as the artist says, reminds him of the subtleness of the draperies of old masters 'sculpture. In both cases, in the paintings and in the sculptures, there is a demand for balance between the instantaneous and brutal act of creating and displaying the fragility and the details carefully preserved in order to reach the entirety of the artwork.



# lajme anëtarësh

Philip Morris Albania prezantoi sot për herë të parë në Shqipëri nismën UNSMOKE – *Çtymos*. Përmes kësaj iniciative, të prezantuar në mjediset e COD-*Qendra për Hapje dhe Dialog*-, kompania lider e duhanit në botë, synon të shpërndajë mesazhin e thjeshtë, që është gjithashtu një pasqyrim i disa prej pozicioneve kryesore të korporatës: nëse nuk pini duhan, mos filloni; nëse pini, hiqni dorë dhe nëse nuk e lini, ndryshoni. *#Unsmokeyourworld* është një nismë e PMI për të shpejtuar një ndryshim historik në shëndetin publik drejt një të ardhme ku cigaret nuk do të përdoren më. Lëvizja *#unsmoke,* synon të krijojë një bashkësi njerëzish që mund ta përshpejtojnë këtë ndryshim. Përforcon mesazhin se heqja dorë nga cigaret dhe nikotina në tërësi, është zgjidhja më e mirë që çdo duhanpirës mund të bëjë dhe për ata duhanpirës të rritur që përndryshe, do të vazhdojnë të pinë cigare, nevojitet një plan i arsyeshëm. Bën thirrje që këtyre burrave dhe grave t'u jepet qasje dhe informacioni rreth alternativave të argumentuara shkencërisht që inovacioni dhe teknologjia kanë mundësuar.

Anis Brahimaj, nga Philip Morris Albania, foli mbi rëndësinë e implementimit të *UNSMOKE* në vendin tonë dhe hapësirave përfshirëse. "*Shqipëria ka një prevalencë të lartë të duhanpirësve që mund të përfitojnë nga një iniciativë që ka arritur mbi 1 milion aktivizime në internet në të gjithë botën*".

Të pranishmit u njohën më nga afër me fushatën *UNSMOKE*, përmes shpjegimit të përfaqësuesit të Philip Morris International nga Lausanne, Mario Moniz Barreto, prej gjenezës së kësaj iniciative dhe zhvillimit të mëtejshëm global. Sipas tij, "*Unsmoke, është një iniciativë që dëshiron të përshpejtojë shkallën në të cilën pirja e duhanit do të bjerë. Ne inkurajojmë të rriturit që nuk pinë duhan që të mos fillojnë, ose nëse pinë duhan, ta lënë. Nëse nuk e lënë, të konsiderojnë kalimin në alternativa pa tym*".

Gjithashtu Mario Moniz Barreto shtoi se "*Pas dekadave edukimi, parandalimi dhe politikave të ndërprerjes, ka akoma më shumë se një miliardë duhanpirës të rritur në botë. Ne besojmë se mund të ndihmojmë në adresimin e këtij problemi global të shëndetit publik, me përpjekje të përbashkëta nga sektori publik dhe privat*",.

Ndërkohë Profesor Edmond Dragoti, Sociolog dhe Psikolog njohu të pranishmit me sjelljet njerëzore dhe sa të rëndësishëm janë shembujt pozitivë në përqafimin e nismave të reja.

*"Njerëzit shpesh janë të prirur të veprojnë në një mënyrë të dëmshme për veten, të dashurit e tyre dhe mjedisin e tyre. Por, ata zakonisht nuk heqin dorë nga kjo sjellje lehtë, sepse gjithmonë do të gjejnë një mënyrë për të racionalizuar zgjedhjet e tyre. Për këta njerëz koncepti i "reduktimit të riskut" është shumë më i mirë në krahasim me qasjen "tolerancë zero". Jepuni njerëzve mbrojtje ndaj diellit në plazh, jepni duhanpirësve alternativa, jepni stevia diabetikëve dhe do të kurseni më shumë jetë se sa me ndalim".*

Së fundmi, gjashtë foto histori nga përditshmëria pa tym, u ekspozuan në këndin e posaçëm të ekspozitave në COD për të ndarë mesazhet personale dhe historitë e atyre që ia kanë dalë të ndryshojnë jetët e tyre për mirë.

**Rreth Philip Morris International: Sigurimi i një të ardhme pa tym**

*Philip Morris International (PMI) po udhëheq një transformim në industrinë e duhanit për të krijuar një të ardhme pa tym dhe të zëvendësojë përfundimisht cigaren me produkte pa tym në dobi të të rriturve, të cilët në të kundërt do të vazhdonin të pinin duhan. PMI është një kompani udhëheqëse ndërkombëtare e duhanit e angazhuar në prodhimin dhe shitjen e cigareve, produkteve pa tym dhe pajisjeve elektronike e aksesorëve shtesë, si dhe produkteve të tjera që përmbajnë nikotinë në tregjet jashtë SH.B.A.-së. PMI po ndërton një të ardhme në një kategori të re të produkteve pa tym, që edhe pse nuk janë të padëmshme, janë një zgjedhje shumë më e mirë sesa pirja e cigareve tradicionale. Përmes aftësive multidisiplinore në zhvillimin e produktit dhe shkencës së avancuar, PMI synon të sigurojë që produktet pa tym të plotësojnë kërkesat e konsumatorit të rritur dhe kërkesat e rrepta rregullatore.*

Gallery 70 Contemporary Art ka prezantuar ekspozitën personale të Jon Krajës. Ekspozita përbëhet prej tablosh në akrilik dhe dy skulptura të realizuara me materiale te ricikluara, prej cikleve më të fundit të autorit. Jon Kraja sjell kërkimin e tij personal të bukurisë tek një botë konsumiste dhe e mbindotur. Nëse në tablotë e tij ai e gjen të bukurën tek hedhja e shpejtë e ngjyrave dhe e rastësishmja që krijohet në përplasjen mes tyre, tek skulpturat ai kërkon ndjeshmërinë e formave që vijnë si rezultat i deformimit të shisheve plastike gjatë procesit të transformimit të tyre prej atij vetë. Ky proces transformimi, si shprehet autori, i kujton atij finesën e drapërive të mjeshtrave të vjetër të skulpturës. Në të dy rastet, si tek tablotë si tek skulpturat, kemi kërkesën për ekuilibër mes aktit të shpejtë e brutal të krijimit dhe evidentimit të delikates dhe detajit që ruhen me kujdes për të arritur në plotësimin e veprës.



# member news

AADF

The AADF has been in Albania for 10 years! At the Palace of Congresses in the presence of 1,000 guests, that included collaborators and beneficiaries of the Foundation's programs. Remarks were given by the Chairman of the AADF Board of Directors Mr. Michael Granoff, special guest Mrs. Victoria Nuland, Tirana Mayor Mr. Erion Veliaj, the Charge D' Affairs of the US Embassy in Tirana Ms. Leyla Moses Ones, Leader of the Opposition Mr. Lulzim Basha, and the personal messages from four US Presidents, Mr. Clinton, Mr. Bush, Mr. Obama and Mr. Trump. This gave the work, the effort of the projects of AADF an unprecedented dimension and extraordinary meaning. They motivated and touched everyone in the great hall and even more so, each member of the most dedicated and talented staff in Albania. With more than 60 million Dollars committed, more than 100 million dollars generated and with an economic impact of more than 250 million Dollars AADF along with its more than 100 national and international partners, convincedly ushered in the second decade of its efforts with clear understanding of the responsibilities it has undertaken, the high expectations of the public for its projects and the performance at the highest international standards required.
Now is the time, and we are ready! Future is today!

Frost & Fire Consulting

Frost & Fire Consulting
Time to reap seems to have come for Frost & Fire Consulting, the legal and financial consulting firm that has been operating in Albania for well over 5 years now. The firm, directed by Managing Partner Rezart Spahia, has come to the forefront of the attention of its clients for the legal precision and quickness with which it addresses all the needs of its clients.
"The lawyers are very professional. The quality of work is excellent and completed within the given deadlines. Last but not least, the partners are very proactive when addressing the open issues." says one of Frost & Fire's mergers & acquisitions clients.
Many of these clients, based on their successful experiences with Frost & Fire, felt the need to comment about their positive impressions and benefits received by working with the firm and its US trained and licensed attorneys, Rezart Spahia and Reshard Kellici. One of their banking industry clients commented that "Frost & Fire is very attractive and valuable due to the thorough and exhausting analysis of every issue involved in any matter. Their service is prompt and every document produced is of international standards." Another client in the same industry thought that the firm's "professionalism, legal acumen, meticulousness and thorough knowledge of Albania's legal framework and its business climate have been clearly demonstrated in the reports, analysis and draft legislation that they have proposed, which have all been of an outstanding quality."
Clients in the project finance and development industry thought that "Frost & Fire Consulting provides quality professional support in helping their clients achieve their goals by playing the needed roles as a counsellor, advocate, negotiator, and problem solver." They believe that this firm "stands for sophistication, expertise, integrity and value" and they highly appreciate the fact that Frost & Fire "is the only law firm in Albania where two of its members are US-qualified lawyers with extensive experience with some of the top global law firms in the corporate, securities, and energy and infrastructure area."
Clients also think that the firm's lawyers "focus on essential things that are important from the point of view of business to bypass difficulties and conflicts and complete the transaction in a way that not only protects our interests but also creates the foundation for a healthy cooperation with anyone we are negotiating."
As one of their clients simply put it, "they are without a doubt the best law firm in the country for corporate and financial work."
And Frost & Fire shows their appreciation for their clients by continuing to offer them a great value package through their international standards work product, accurate and practical legal advice, unmatchable integrity and second to none commitment to their clients' interest.

# lajme anëtarësh

AADF

AADF bëri 10 vjet në Shqipëri! Në Pallatin e Kongreseve, në praninë e mbi 1000 të ftuarve, të gjithë bashkëpunëtorë apo përfitues të programeve të Fondacionit, fjala e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve, zotit Michael Granoff, fjala e të ftuarës speciale zonjës Victoria Nuland, fjala e Kryetarit të Bashkisë, zotit Erion Veliaj, fjala e të Ngarkuarës me Punë të Ambasadës së SHBA-ve, zonjës Leyla Moses-Ones, apo ajo e kryetarit të opozitës, zotit Lulzim Basha, dhe në mënyrë të veçantë, katër mesazhet personale të katër Presidentëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Clinton, Bush, Obama dhe Trump, i dhanë një dimension të paprecedentë dhe një kuptim të jashtëzakonshëm punës, përpjekjeve, rezultateve dhe projekteve të AADF-së. Ato motivuan dhe emocionuan gjithkënd në sallë, por më së shumti, secilin prej anëtarëve të stafit më të përkushtuar dhe më të talentuar në vend. Me mbi 60 milionë USD të angazhuara, mbi 100 milionë USD të ngritura dhe me një impakt ekonomik mbi 250 milionë USD, AADF në bashkëpunim me mbi 100 partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë me të cilët ai bashkëpunon, hyn në dhjetëvjetorin e dytë bindshëm dhe me vetëdije të plotë për përgjegjësitë që ka marrë përsipër, pritshmërinë e lartë që publiku ka ndaj projekteve të tij dhe performancës në standardet më të larta botërore.
Koha nuk pret, ne jemi gati!
E ardhmja është sot!

Frost & Fire Consulting

Frost & Fire Consulting
Koha për të vjelë frytet e punës duket se ka ardhur për Frost & Fire Consulting, firma ligjore dhe financiare që operon prej pesë vitesh në Shqipëri. Firma e drejtuar nga Partner Administratori, z. Rezart Spahija, është vendosur në qendër të vëmendjes së klientëve të tyre, për precizionin ligjor dhe shpejtësinë me të cilën adresojnë të gjitha nevojat e tyre.
"Juristët janë shumë profesionalë. Cilësia e punës është e shkëlqyer dhe e përfunduar brenda afateve të dhëna. Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, partnerët janë shumë proaktivë kur adresojnë çështjet e hapura", - shprehet një nga klientët e Frost & Fire.
Shumë nga këta klientë, të kënaqur nga bashkëpunimi i suksesshëm me Frost & Fire, kanë ndjerë nevojën të vlerësojnë nëpërmjet komenteve ndjesitë pozitive dhe përfitimet nga puna me firmën juridike që drejtohet nga dy avokatë të arsimuar dhe të licensuar në Amerikë, z. Rezart Spahija dhe z. Reshard Këlliçi. Një nga klientët e tyre nga industria bankare komentoi se "Frost & Fire është shumë tërheqëse dhe e vlefshme për shkak të analizës së plotë dhe të vlefshme, si rrjedhojë e një analize të thelluar të çdo elementi që përfshihet në çështje. Shërbimi i tyre është i shpejtë dhe çdo dokument i prodhuar është i standardeve ndërkombëtare. "Një klient tjetër, i po të njëjtës industri mendoi se "profesionalizmi, mendjemprehtësia ligjore e firmës, përpikmëria dhe njohja e plotë e kornizës ligjore të Shqipërisë dhe klimës së biznesit në vend, janë demonstruar qartë në raportet, analizat dhe projektligjet që ata kanë propozuar, të cilat kanë qenë të gjitha me një cilësi të jashtëzakonshme".
Klientët e industrisë financiare dhe zhvillimit të projekteve menduan se "Frost & Fire Consulting ofron mbështetje profesionale cilësore, për të ndihmuar klientët e tyre të arrijnë objektivat duke luajtur rolet e nevojshme si këshilltar, avokat, negociator dhe zgjidhës të problemeve. "Ata besojnë se kjo firmë "shquhet për sofistikim, ekspertizë, integritet dhe vlerë" dhe ata vlerësojnë shumë faktin që Frost & Fire "është e vetmja firmë ligjore në Shqipëri, ku dy prej anëtarëve të saj janë avokatë të kualifikuar në SH.B.A., me përvojë të gjerë në disa prej firmave më të mira globale në fushën e korporatave, sigurimeve, energjisë dhe infrastrukturës".
Gjithashtu, klientët mendojnë se avokatët e firmës "përqendrohen në elementë thelbësorë që janë të rëndësishëm nga këndvështrimi i biznesit, për të anashkaluar vështirësitë dhe konfliktet dhe për të përfunduar transaksionin në një mënyrë që mbron jo vetëm interesat tona, por që krijon gjithashtu themelet për një bashkëpunim të shëndetshëm me këdo që po negociojmë". Siç shprehet thjesht një prej klientëve "ata janë pa dyshim firma më e mirë juridike në vend për punë të korporatave dhe çështjeve financiare". Frost & Fire demonstron vlerësim për klientët e saj, duke vazhduar t'u ofrojë atyre një paketë me vlerë të madhe përmes produkteve të tyre të standardeve ndërkombëtare, këshillave ligjore të sakta dhe praktike, integritetit të pashoq dhe dedikim të pakrahasueshëm për interesat e klientëve të tyre.



# ETHICS in BUSINESS

## A MARATHON DEBATE



**The Labor and Ethics Committee of AmCham Albania organized a conference centered on ethics in the business community in Albania.** Olindo Shehu, a keynote speaker at the event, brought his personal and professional perspective on the topic.

**Olindo Shehu**
Partner | Tax & Legal | Deloitte Albania & Kosovo

### WHAT'S THE STORY?

Ethics has been an ever-evolving subject in our society from the beginning of time. I will not reference any specific milestones to further elaborate on that, but what I find striking is how the fundamentals of ethics in any discipline of life remain the same regardless of what words we use to dress them up: autonomy, beneficence, justice and fidelity. Every individual is free to decide how they want to live their lives, provided they do no harm to others, they promote the health and well-being of others, and they are fair in how they interact with others.

### GROUND-UP ETHICS

Organizations invest vast amounts of resources to establish and maintain detailed codes of ethics that aim to cover all possible grounds they operate on and beyond, because ethics extends far beyond the confines of a business. Ethics reflects the values and, to some extent, the society in which a given business or profession is positioned. It would be no good thinking that by drafting intricate codes of ethics one would be able to mold highly ethical individuals no matter what. Developing a culture within an organization based on solid ethical grounds is an ongoing process that does not begin the first day an employee starts working. I am a firm believer that ethics is deeply grounded in a person's family, then strongly supplemented by education - from day care all the way to university - and finally, further nurtured in the work environment. As such, the three main pillars that I see playing a crucial role in someone's ethics principles are: family, society and its education system, and the work environment.

### TRICKLE-DOWN ETHICS

In a healthy society, public and private organizations play a key role in ensuring the smooth progress of any individual on their ethics journey. Unfortunately, in Albania, this is not always the case. Some businesses operate like isolated islands in a sea of mixed ethical standards. Therefore, the responsibility of conveying clear and consistent ethical messages to the workforce becomes enormous. Making the right choice when hiring individuals is without doubt important. However, leading by example, regardless of the surroundings, is what ultimately keeps ethicability in check amongst professionals. As a leader in one of the most prominent professional services firm in the world and in Albania, I live with the responsibility of leading by example every day. This responsibility is not only towards my team of colleagues, but also towards new graduates, society, friends, many of whom, through no fault of their own, are ethically misaligned.

### WHAT'S NEW?

Theoretically speaking, I don't think anything has changed in the ethics realm. It has been, it is, and it will remain a highly subjective matter of discussion, despite efforts to make it otherwise. From the perspective of a business leader in Albania, I believe changes ought to be made from the ground up. No one comes into this world unethical. They may become one growing up conditioned by varying circumstances. I will not comment on how families are raising their children in Albania because that is something I do not know. What I do know is that no parent wishes for their child to become unethical, even if they are so themselves. Yet, families do not operate isolated from society when raising their children and in that respect, the Albanian education system and society as a whole have very little to offer in terms of creating and inspiring ethical individuals. Ethics must be firmly embedded into the curriculum as early as kindergarten, and all the way up to university. School years are vital in helping lay the ethical foundations of any individual. Without these foundations, it is absurd to expect anyone to practice being ethical later in life. Furthermore, parents, teachers, politicians and business leaders should invest physical time building trust with their respective groups of interest. That means sharing success and the burden of mistakes, which are inevitable, without pointing fingers at or scapegoating anyone. Every successful individual knows that their achievement depends on a community of people working together. Just like success doesn't depend on a single individual, failure is a process that should be dealt with as a team.



# ETIKA *në* BIZNES

## NJË DEBAT MARATONË

**Në konferencën e organizuar nga Komiteti i Punës dhe Etikës i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri, të përqëndruar rreth çështjeve të ndryshme etike me të cilat përballet komuniteti i biznesit në vend,** Olindo Shehu, një prej pjesëmarrësve në panel, ofroi perspektivën e tij personale dhe profesionale mbi temën e etikës në biznes.

**Olindo Shehu**
Partner për taksat dhe Çështjet Ligjore
| Deloitte Albania & Kosovo

### PAK HISTORI

Etika ka qenë një subjekt në zhvillim të vazhdueshëm që me fillimet e shoqërisë njerëzore. Nuk dua të ndalem dhe t'i referohem momenteve specifike të zhvillimit të kësaj fushe, por është shumë domethënës fakti se si bazat e etikës në çdo fushë të jetës mbeten të njëjta pavarësisht fjalëve që mund të përdorim për t'i përshkruar ato: autonomia, bamirësia, drejtësia dhe besnikëria. Çdo individ është i lirë të vendosë se si do të donte ta jetonte jetën e tij për sa kohë nuk dëmton jetën e të tjerëve, ndihmon në shëndetin dhe mirëqenien e tyre dhe është i ndershëm në mënyrën e sjelljes me ta.

### THEMELET E ETIKËS

Organizatat investojnë sasi të mëdha burimesh për të pasur kode etike të detajuara, që janë të domosdoshme për të mbuluar të gjitha fushat ku ato veprojnë dhe jo vetëm. Etika shkon edhe më tej se kufijtë e një biznesi. Ajo reflekton vlerat dhe deri në një farë mase edhe shoqërinë në të cilën një biznes ose profesion funksionon. Të shkruarit e kodeve etike të ndërlikuara jo domosdoshërisht formojnë individë me etikë të lartë. Zhvillimi i një kulture të mbështetur në themele të forta etike brenda një organizate është një proces i vazhdueshëm që nuk fillon që në ditën e parë të punës së një punonjësi. Unë besoj fort se etika është e rrënjosur thellë në familjen e secilit prej nesh; më vonë plotësohet me arsimimin që ne marrim nga çerdhja e deri në universitet, dhe ushqehet më tej në mjedisin e punës. Si rezultat, tre janë shtyllat kryesore që mbështesin formimin e parimeve etike të një personi: familja, shoqëria me sistemin e saj arsimor, dhe mjedisi i punës.

### SHEMBULLI I SJELLJES ETIKE

Në një shoqëri të shëndetshme, organizatat shtetërore dhe private luajnë rol kyç në sigurimin e progresit të çdo individi në rrugëtimin e etikës. Për fat të keq, kjo nuk ndodh në mënyrë uniforme në Shqipëri. Disa shoqëri funksionojnë si ishuj të izoluar në një det me standarte të përziera etike. Si rezultat, përgjegjësia për të përçuar tek punonjësit mesazhe etike të qarta dhe të vazhdueshme është shumë e madhe. Pa diskutim, një rëndësi të veçantë luan edhe procesi i përzgjedhjes së kandidatëve të duhur për pozicione të ndryshme pune. Megjithatë, ajo që vërtet e bën dallimin në Shqipëri është vendosja e shembullit të sjelljes etike gjatë të gjithë kohës, pavarësisht rrethanave. Si drejtues i një prej firmave më të njohura në botë dhe në Shqipëri, unë jetoj çdo ditë me përgjegjësinë e të drejtuarit me shembullin tim personal. Kjo përgjegjësi nuk është vetëm ndaj kolegëve të mi, por edhe ndaj të sapo-diplomuarve, shoqërisë, miqve, shumë nga të cilët, jo për faj të tyre, nuk kanë sjelljen etike të duhur.

### TË REJAT E FUNDIT

Në aspektin teorik, nuk mendoj se ka pasur ndryshime thelbësore në fushën e etikës. Ka qenë, është dhe do të mbetet një temë relativisht subjektive, përtej përpjekjeve për ta ndryshuar disi. Nga këndvështrimi im si një drejtues biznesi në Shqipëri, mendoj se duhet të ndërmerren disa ndryshime rrënjësore. Askush nuk lind me sjellje jo etike. Këto sjellje formohen me kalimin e kohës të ndikuara nga rrethana të ndryshme. Nuk dua të bëj komente mbi mënyrën se si familjet po i rrisin fëmijët në Shqipëri, pasi nuk kam si ta di me siguri. Ajo që di mirë është se asnjë prind nuk do të donte që fëmija i tij të mos kishte sjellje etike, edhe pse ai vetë nuk mund t`i ketë këto sjellje. Pavarësisht kësaj, familjet nuk veprojnë të izoluara nga shoqëria kur rrisin fëmijët. Në këto kushte, shoqëria shqiptare dhe sistemi arsimor në Shqipëri nuk kanë shumë për të ofruar në lidhje me krijimin dhe inkurajimin e individëve me sjellje etike. Etika duhet të rrënjoset fort në kurrikula që nga kopshti e deri në universitete. Vitet e shkollës janë jetësorë në formimin e themeleve të etikës për çdo individ. Pa këto themele do të ishte absurde të prisje nga çdo njeri të sillej në mënyrë etike në jetë. Gjithashtu, prindërit, mësuesit, politikanët dhe drejtuesit e bizneseve duhet të investojnë kohë fizike për të krijuar besimin me grupet e tyre të interesit. Kjo nënkupton të ndash edhe sukseset, edhe gabimet, të cilat janë të pashmangshme. Çdo person i suksesshëm e di mirë se suksesi varet nga një komunitet njerëzish që punojnë së bashku. Ashtu si suksesi nuk varet nga një person i suksesshëm, edhe dështimi është një proces që duhet menaxhuar në grup.

# WELCOME
## new members

**Celular.al**

*SHORT BUSINESS PROFILE*

**Liam Ltd.** was founded on April 18, 2017. The company activity is based on import-export, trade and services for telephone accessories and other electronic equipment; installation, maintenance, retail and wholesale of electronic devices, telephone sets, computers, etc. Liam Ltd. is the Agent of EasyPay for the provision of services including invoice payments, sales of EasyPay affiliate goods & services, electronic recharge, etc.

**Liam Ltd.**
Representative: Ferdinand Kafeja, Administrator
Address: Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga Konferenca e Pezës, Pall. 160/1/2, Nr. pasurie 5/233N-2, Z. Kadastrale 8220, Tiranë
Contacts: +355 (0) 672040666, liamshpk@gmail.com
Activity: Import-Export. Trade and Service for Electronic Equipment.

www.celular.al

**LUFRA**

*SHORT BUSINESS PROFILE*

Founded in 1992, **LUFRA** has continued to expand both geographically and also on the variety of products offered in the market. 2013 marked the start of the TetraTop collaboration for the provision of the fresh dairy products through the ESL (Extended Shelf Life) system. Certainly, furthermore the factory has expanded by doubling its capacity and the laboratory for the milk analysis was fully modernized.

**LUFRA**
Representative: Franc Nreka, COO
Address: Lushnje-Fier, Km. 7, Tiranë
Contacts: +355 (0) 689022120
franc.ndreka@lufra.al
Activity: Dairy. Production and Distribution of Milk Products.

www.lufra.al

**PIK**

*SHORT BUSINESS PROFILE*

Advertising and communication agency offering 360' integrated communication solutions covering everything ranging from strategic consulting and creative services, design and execution of awareness/ communication campaigns, graphic design, Brand identity development and positioning. Event management, PR services, Media planning and Media buying, Web design & Development and Digital management, Digital marketing and more. Strong practice in working with public sector institutions, NGOs and private sector companies. Fully committed to quality and innovation capable of inventing, planning, building and exceeding customers and partners' expectations.

**PIK Sh.p.k.**
Representative: Alban Fejzaj, CEO
Address: Rr. Pjetër Bogdani, Nr. 37, Tiranë
Contacts: +355 (0) 697053455
a.fejzaj@pik.al
Activity: Advertising and Marketing Communications, Brand Development and Graphic Design; Digital Services, Web Design, Social Media Management. Event & Promotional activities Concept and Implementation.

www.pik.al





# MEET THE PATRONS of AMCHAM ALBANIA

*Patron is the highest-status category for member businesses of the American Chamber of Commerce in Albania*

Advantage


# InfoSoft Systems

*... stronger together ...*

"InfoSoft Systems, specialized in system integration, provides technological consultation, implementation and support services to small, medium and large size organizations. Successful and challenging in the region, a recognized leader in Albania, with more than 28 years of experience, InfoSoft Systems continues to collaborate with clients, helping them expand and grow their businesses."

Adress: Rr. Murat Toptani, Gjergji Center,Tiranë, ALBANIA
E-mail: infosoft@infosoftgroup.com.al
Web: www.infosoftsystems.al



Baker Hughes

# We take energy forward—making it safer, cleaner, and more efficient for people and the planet




Unique problems
need unique solutions.
Deloitte.


EY
Building a better working world
What will be more important in the future, the right skill set or mindset?
ey.com/betterworkingworld #BetterQuestions
EY | Audit | Tax | Transactions | Advisory
The better the question. The better the answer. The better the world works.

qed.

one vision.



Holly & Endi Auditing

Simplify to grow

Address: Blv. "At Gjergj Fishta", Pall.E88, Nr.12, KP.1001, Tirana, Albania.
Tel.fax. +355 42 270905, email: hollyendiauditing@gmail.com

Berdica cement

Leading distributor of ingredients and additives for the building materials industry in Albania and Kosovo

connecting industries



Providing top quality products, customer service, and technical support

www.berdicacement.al



dimapak
make it easy




Dimapak is providing innovative and sustainable end of line packaging solutions for industry, including packaging machineries and consumables.

Under the motto **GO GREEN** our goal set is to provide environmental friendly products and less polluting solutions, to contribute to the creation of a cleaner and more sustainable world for us and future generations.

Packaging films we offer are also from renewable sources bringing **less weight of plastic** in the environment and **cost reduction** for our customers.



T:+355 4 240 6764
F: +355 4 240 6766
W: www.dimapak.com
Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Nr 82,
Kashar, Tiranë, Albania



# SALILLARI
## COMPANY PROFILE

SALILLARI LTD our company is involved in construction activities of both industrial and civil projects and those of infrastructure, from roads and highways to industrial complexes and housing. With the new changes happening around us and such development infrastructure projects in our country we have to grow leaner, more competitive and efficient.

## THE MAIN CONSTRUCTION ACTIVITIES OF THE COMPANIES ARE:

**01**
Transport infrastructure works.
(highways, roads & bridges)

**02**
Site oil drilling construction, seaport and runway airport works.

**03**
Other Civil engineering works

**04**
Industrial & building works.

**05**
Irrigation & environment protection projects.

**06**
The production of construction materials.
(such as aggregates, concrete, asphalt, etc) through its own construction sites, quarries, concrete mixer and asphalt plants;

**07**
Pipe and pipe water supply works.

**08**
Design of civil and industrial works etc.

Rruga e Vjetër Vorë - Marikaj, Km 1, Shqipëri.
Tel: +355 47 644 047
info@salillari.al
www.salillari.al

Salillari






ELEGANT VILLAS IN THE
ASTONISHING ALBANIAN RIVIERA
· SMART INVESTMENT
· PROPERTY FINANCING
Villas for Sale
Palasa - Albania
www.greencoast.al
sales@greencoast.al
+355 698014999
GREEN COAST
RESORT AND RESIDENCES




Wishes
the american community and all its members:
Happy
Thanks Giving

# Kape shtëpinë me 1%




## KREDIA JUAJ PËR BLERJE SHTËPIE

1. Normë Interesi tepër konkurruese në EURO:
   · 1% fiks për një vit dhe më pas Euribor 12M+3.80%, min 3.80%,
   · 2% fiks për dy vjet dhe më pas Euribor 12M+3.80%, min 3.80%
2. Afati i ripagimit deri në 30 vite
3. Procedurë e shpejtë aprovimi dhe asistencë profesionale

Ofertë e limituar në kohë. Aplikohen kushte të përcaktuara.
Drejtohuni në një nga degët tona dhe stafi ynë do të jetë i lumtur t'ju ndihmojë.

**info: www.abi.al**

abi
AMERICAN BANK OF INVESTMENTS
*investo në optimizëm*